

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME AJTENE PLLANËN

Prishtinë | Data: 21 nëntor, 2018

Kohëzgjatja: 102 minuta

Të pranishëm:

- Ajtene Pllana (E intervistuar)
- Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Kaltrina Krasniqi: A mundeni me na tregu diçka për fëmininë e juv? Çfarë fmije keni qenë? Ku keni jetu? Për familjen? Për vjet e para t’jetës t’juv?

Ajtene Pllana: Unë jam e lindur në Shkup. Prindërit i kam, babën e kam shkupjan, nanën e kam nga Presheva. Janë martuar në vitin 1930 edhe baba im ishte i vetëm, mirëpo kishte shumë dëshirë të ketë shumë fëmijë. Kështu që, kemi qenë tetë fëmijë, kurse dy kanë ndrru jetë ende si foshnje të vegjël dy djem, e ne ishim katër vllazën edhe dy motra, unë jam e treta me radhë.

Mund të them që kemi pasë ni fëmini shumë, shumë të mirë deri në vitin 1946. Jetonim bashkë me gjyshin edhe gjyshen. Në ‘41-shin atëherë kur filloi lufta nga frika se mos po ndodh diçka shumë rrezik mos është në Shkup të mbetemi, shkuam në shtëpinë e nënës, të gjyshes time ku jetonte tezja në Preshevë, një vit e kaluam atje. Mirëpo, në Shkup nuk kishte pasë ndonjë luftë të madhe, aty masi kanë hy Bugarët ata kanë qenë në koalicion me Gjermanët edhe pak diçka ka pasë.

E kështu ‘44-shin, në fund të ‘44-shit u kthyem nga Presheva. Atëherë u hapën shkollat e para në gjuhën shqipe, për herë të parë në historinë e popullit shqiptar, shkollat e para. Unë edhe pse isha shumë e vogël e pata një djalë, ishte djali i axhës t’babës nga Gilani pat’ ardhë edhe ai tha, “Unë do t’iu çoj në shkollë”, ai me na regjistrua. Kur më çoi mua nuk më pranoi drejtori se tha, “Shumë e vogël”, gjashtë vjeçare, ai axha, “Hajde, hajde merre vajzën” thotë se, “i ka gjashtë vjet e gjysëm”. Nejsë kështu unë u bëra nxënjsja e paraleles t’parë të historisë së qytetit të Shkupit, një shkollë në gjuhën shqipe edhe isha ma e vogla në klasë.

Mirëpo, qe krejt rasisht ndodhi që në klasë të kishte vajza nga 15-14-12 vjeçare në klasë të parë filllore, e mbas ji viti, dy e ndërpre në shkollimin. E në vitet e më vonshme shkuan në Turqi, ishte koha kur njerëzit me t’madhe shkonin atje e kështu unë mbeta. Pastaj u hap edhe Shkolla Normale, prej Tetove u bart në Shkup edhe vazhdova Shkollën Normale. Nana kishte dëshirë se motrat e veta në shekullin e XIX kishin qenë mësuese, natyrisht në gjuhën turke se shkollë shqipe s’ka pasë edhe... kështu që prej gjeneratës t’parë krejt rastësisht, jo pse isha unë ndonjë shumë e zoja apo, por qëllloi që unë të jem mësuesja e parë e shkollës t’parë shqipe në Shkup. E disi tash, përpara nuk i kam dhanë ndonjë rëndësi, por tash disi sikur krenohem që unë kam qenë ajo që... (qeshë). Njeriu gjithmonë mundohet të gjej diçka ashtu që i konvenon që i duket se është mirë.

Edhe mendoj deri në vitin '46 kishim një jetë shumë, shumë të mirë. Babai ka qenë shumë njeri bashkëkohor shumë ashtu... mirëpo '45 më erdhi... '46 gjatë verës më erdhi daja, ai ishte në organizatën Nacional Demokratike Shqiptare, profesori Ibrahim Kelmendi. Ka qenë profesor i historisë në Gjimnazin e Prishtinës, ka diplomu në Zagreb historinë. Ai ishte edhe luftëtar edhe erdhi në shtëpinë tonë kërkoi ashtu të qëndrojë një kohë, baba tha, "S'ka problem", dy javë ndejti ke ne. Ata i paskan mbajtur ato mbledhjet që organizata ka funksionuar në Shkup. Pas dy jave shkoi e pas një kohe ma burgosën babën edhe atëherë fillon një jetë shumë tepër e randë (qan) për familjen tonë, mbetëm pesë fëmijë me një nënë shtëpiake. Vëllau ma i madh ishte dymbëdhjetë vjeçar, as dymbëdhjetë vjet s'i kishte, ma i vogli ishte një vjet e gjysëm edhe ato vite vetëm ne i dijmë (qan).

Ishin vite t'randa, mirëpo kjo (qan) disi sikur na ndjekte gjatë tanë jetës. M'u burgos vëllau i madh, ishte jurist, diplomoi drejtësinë. U burgos babai, vëllau, mandej vëllau tjetër, mandej erdhën '81-shi erdhi motrën ma qitën prej pune arsimitare e gjuhës shqipe, vëllaun tjetër profesor edhe gazetar ishte. Gjithmonë kishim kështu peripetina, mirëpo qëndruam edhe jemi të parët nga qyteti i Shkupit që të gjithë u shkolluam, përveç një vëllau që megjithëse ishte ndër më të zgjuar, zgjuarit në familje, ai donte biçiklist të punojë, nuk kreu ndonjë shkollë të lartë. E ne të tjerët u shkolluam kishim një jetë normale ashtu, familja u rritë, u martuam. Tash isha në Shkup, mirë janë ashtu një jetë normale bëjnë.

Kaltrina Krasniqi: Si ishte jeta në Shkup ato vitet e luftës kur ju keni qenë atje?

Ajtene Pllana: Po shihni, njerëzit ishin në atë kohë shumë të thjeshtë shumë edhe ashtu kishin një sikur... njerëzve u vinte turp ose ashtu të ankohen ose neve, për shembull, askush s'e dinte se si po jetojmë në shtëpi, por nuk ishte lehtë, nuk ishte lehtë duheshte luftuar për elementaren, buka ishte kryesorja. Ni copë bukë të ipshin për tanë ditën, ajo na takonte, ma tepër jo. Ata që ishin të fshatrave kishin ma tepër mundësi, qasje rreth ushqimit, rreth... mandej vinte puna dru edhe ato me triska, ushqimet e tjera, me triska... Por, sa i përket shkollave, u hapën shkollat edhe kishte ni kujdes për fëmijët, për shembull, në pushime verore i dërgonin fëmijët nga një muaj, nga dy, tri javë pa pagesë ose në det, ose në male, ose diçka. Jo paketat vinin nga Amerika "UNRA" i lshonte dhe sado pak ashtu ndihmonte në ekonominë e njerëzve.

Nuk ishte e lehtë, por i kapërcyem ato vite. Kush kishte ndonjë pozitë ma t'lartë edhe atëherë, edhe në atë kohë i kanë pasur punët më mirë. Por ne, për shembull, për ne nuk kishte kush t'kujdesej fare. Ne si familje kemi vuajtur shumë, por askush nuk ka ditë. Nëna ka qenë shumë krenare edhe gjithsesi është munduar që t'mos mirrej vesh ashtu.

Kaltrina Krasniqi: N'çfarë lagje keni jetu? Çfarë qyteti ka qenë Shkupi?

Ajtene Pllana: Shkupi... shifni Shkupi ka qenë... Shkupi është ndarë në dy pjesë, Vardari e ka nda në dy pjesë. Unë nuk di më duket vetëm nja tre-katër familje shqiptare kanë jetu përtej urës, ne gjithnjë kemi thanë matanë urës ose n'anën tjetër ashtu e kemi ndarë Shkupin, matanë urës edhe këndeje urës. Pjesa e vjetër e qytetit... Unë kam jetuar aty ku është ura e gurit pak pastaj vjen, aty, nëse e dini Shkupin aty ku është përmendorja e Skënderbeut ndoshta nja njëqind metra përtej ka qenë shtëpia e jonë. Mund të thuhet që ka qenë bukur qendra ashtu nuk ka qenë periferi.

Pjesa e re... pjesa përtej Vardarit ka qenë shumë qytet i bukur, ndërtesat shumë... pas luftërave ballkanike ishin ndërtu shtëpi të reja, ndërsa kjo pjesa e jonë këndeje ishte kryesisht orientale, shtëpi

orientale. Ndonjë shtëpi ma e madhe, ma e bukur, ma ashtu... rrugët tek pas luftës filluan asfaltimet pak ku është xhadeja e re aty, rruga e re që e lidh Bit Pazarin me Urën e Hekurit, atëherë ka qenë Ura e Hekurit. Po disi ka pasë një rregull në qytet, ka qenë qytet shumë i pastërt ne çdo ditë është dashtë patjetër para dyrve t'lash oborrin, rrugën ta fshijmë. Cdo pranverë muret e shtëpive është dashtë patjetër... me ligj ka qenë që të ngjyrosen qoftë vetëm me gëlqere ose me ngjyrë.

Ai pastruesi, ai që e mblidhte bërlllogun, bërlllogxhia, çdo ditë vinte vetëm një... Me një ashtu, *brrr* {onomatope}, i binte edhe ne veç dinim që ka mbri. E si të them, pastaj filloi ndërtimi, u ndërtuan shkollat. Ne shkolla nuk kishim, shkollat tona ishin nëpër oborret e xhamive aty ku ka qenë mejtepet prej përpara kohës së Turqisë, e në ato shkolla herë në një shkollë herë në tjetrën deri në klasën e katërt ne rregullisht duheshte t'i ndrojmë shkollat ku gjejmë diçka.

E mandej kur arritëm në klasën e parë gjimnaz, atëherë klasa e pestë thuhej klasa e parë gjimnaz, u ndërtua një shkollë shumë e bukur, shkolla "Liria", që sot i kam lakmi asaj shkolle, ka qenë diçka fjala e fundit. Çdo gja ka pasë aty, çdo klasë e ka pasë aty edhe ujin, çeshmen ku i lajshim durtë, ose syngjerin, ose ka pasë sallë t'kinemasë edhe t'shfaqjes, ka qenë poshtë mensa, plus kanë qenë edhe banjot mbas orës së fiskulturës për me u la fëmijët. Megjithëse, më duket se shumë pak është përdorë, nuk e di n'bodrum kanë qenë me dru nxeheshte uji.

Ka qenë në shkollë tepër e mirë shumë ka pasë disiplinë. Arsimitarët i kemi pasë kryesisht të Shqipërisë kanë qenë, ose të Maqedonisë, ose të Kosovës që janë shkolluar atje. E di mësuesja ime e klasës dy, atëherë ndroheshin çdo vit ndroheshin mësuesit. Mësuesi im i parë ka qenë nga Presheva, e mësuesja e dytë ka qenë në dibrane e shkolluar në Tiranë, ende m'tingllon zëri i saj, diksioni i saj si fliste e ne nuk dinim shqip ne kryesisht flitnim turqisht edhe pse shqiptar.

Disi e pata pyet vëllaun ma vonë, "Pse kështu?" Thotë, "Po gjuha e prestigjit, njerëzit kanë ashtu me gjuhën turke" me gjuhën turke ke pasë një tjetër tretman apo, edhe...mirëpo e mësuam në shkollë, kishim arsimtar të mirë. Për shembull, ke ne ka dhanë mësim edhe doktor Petro Janura, ka qenë mësues i shkollës fillore, pastaj ka qenë Petro Kavaja, ka qenë Mahmut Dumani nga Shqipëria edhe shumë të tjerë. Shumë, plot kanë qenë. Tash kush ka dhanë më shumë ke une mësim ma shumë po i mbaj në mend. Vëllezërit po ashtu kanë pasë.

Mirëpo kur erdhi '48-shi kur u nda Jugosllavia prej Ruisë u prishën punët edhe me Shqipërinë. Atëherë ata i kthyen në Shqipëri ose të zgjedhin ku duan. A duan në Shqipëri apo në shtetet e perëndimit? Dikush shkoi në Amerikë, dikush në Itali e dikush u kthye përsëri në Shqipëri prej arsimtarëve. Ata e kanë, i kanë meritat ma t'mdha që ne e mësuam gjuhën mirë. Fëmijët në shkollat e Shkupit e flitnin gjuhën shumë bukur, shumë kishin... edhe punonin shumë me neve.

Kaltrina Krasniqi: Çfarë fëmije keni qenë ju? Çfarë temperamenti keni pasë?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Çfarë lloj fëmije keni qenë ju? Çfarë temperamenti keni pasë?

Ajtene Pllana: Po fëmijë, si fëmijë (qeshë) si gjithkund. Ne nuk i kishim kushtet e sotme apo? Në rrugë, për shembull, sa i përket lagjes, shoqet, lloj-lloj lojnat... djemtë diçka tjetër e pastaj në shkollë gjithashtu fëmijë të gzushëm, fëmijë që nuk dinim për ma mirë në atë kohë apo? Aq sa na servoheshte

ne ishim të knaqur. Mirëpo, shumë do të thotë qasja e arsimitarëve ishin shumë ashtu... shifni arsimtari edhe me qëndrimin e vet edhe me sjelljen e vet ndikon ke nxënësi, se nxënësi gjithmonë mundohet ta kopjoj. Unë, për shembull, gjithmonë i kam shiku msuset e mia, se janë ndrru dy a tre, edhe gjithmonë mundoheshim... se ishin diçka ma tepër se nanat tona apo? Edhe kështu fëmijët si fëmijë me pak kështu, si të them, kërkesa se nuk kishe çka t'kërkosh ma shumë, qeshtu.

Kaltrina Krasniqi: Mandej keni vazhdu prej shkollimit fillor si ka qenë sistemi?

Ajtene Pllana: Po. Një vit e ndërpreva, e krewa klasën e shtatë fillore edhe s'kishte shkollë duheshte të rrijë në shtëpi. Babanë e kisha në burg ende edhe unë mbeta, fillova shtëpiake të bëhem të shkoj në treg, të gatuj, t'i ndihmoj nënës pak edhe vitin e ardhshëm u hap klasa e tetë, në atë kohë klasa e tetë se u ndrru pastaj nuk ishte gjimnaz por shkollë fillore, klasa e tetë. Edhe unë shkova në klasë aty fillova shkollën. Në atë kohë erdhën drejtori edhe disa arsimtar edhe na lutën që vajzat ende pa e kryer klasën e tetë shkollën fillore le t'vijne në [Shkollë] Normale se shumë kemi nevojë për femna krejt janë gati mashkuj në Normale.

Edhe disa vajza shkuan, tri a katër shkuan, mua babai, “Jo, jo, jo mësuese jo t'bëhesh, do t'bëhesh mjeke, do të bahesh diçka, n'gjimnaz do t'shkojsh”, “Babush,” thojsha, “nuk kam unë... nuk kemi shkollë në gjuhën shqipe duhet maqedonisht”, “Ani, ani qe Amiri po shkon...”, vëllau i madh, “Në gjimnazin maqedon edhe ju shkoni”. Mirëpo, jo në vitin e ardhshëm pastaj u regjistrova në gjimnaz, në gjimnazin maqedon. Vëllaun e kisha atëherë maturant aty në gjimnaz edhe ni ditë m'pyti, “Si po t'shkon?” Thashë, “Shumë vështirë kurgjo s'po kuptoj”, “Pse? Ti po din maqedonisht”, “Po di po çdo gja e re për mua ndaq fizikë, ndaq kimi, ndaq matematikë edhe gjuha bile krejt”, “A din çka? Merri dokumentat shko në Normale” mezi prita, por thashë, “Baba...” tha, “Kush po e pyt babën hajt ti shko atje”.

Mandej kur e murr vesh baba a bajagi, “Në çfarë shkolle po shkon ti?” Thashë “Po shkoj n'gjimnaz”, “Mos je gabim?” “Jo,” thashë, “nuk jam gabim” ai vëllau tha, “Shuj ti mos e mundo vajzën. Unë i kam thanë me shku në Normale” edhe mirë u bo pastaj e krewa, po për pesë vjet. Unë gjithmonë nji fare fati kam pasë ashtu, ku për gjeneratën time u bo Normalja me pesë vite, pastaj menihere u kthy për katër vite Normalja. Kështu që, një vit ma tepër. Kështu, Normalja ishte ni shkollë shumë, shumë kishim rend, rregull, ishte nji shkollë e mirë, kishim nxënës shumë të mirë, arsimtarë po ashtu. Por, vajza kishte shumë pak në klasën tonë. Ishim vetëm tre maturante kur e krym Normalen ishim veç tre vajza.

Kaltrina Krasniqi: Pse kishte pak vajza?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Pse kishte pak vajza?

Ajtene Pllana: Po shumica, shumica emigruan për Turqi, e nji pjesë ishin njerëzit ende fanatik a din, “Çka kërkon vajza në shkollë të shkoj le të rrijë në shtëpi” edhe nuk i dërgonin. Shkupjanët kanë qenë shumë fanatik nuk kanë qenë si në Prishtinë. Kur erdha në Prishtinë pash më përparimtar se shkupjanët edhe kështu ngadaldale u ndryshun gjërat edhe panë se mirë është edhe femra të shkollohet, qeshtu.

Kaltrina Krasniqi: E keni ni moment në librin e juv kur flisni edhe për ferexhen.

Ajtene Pllana: Po, po.

Kaltrina Krasniqi: A mundeni me fol pak ma detalisht për atë moment?

Ajtene Pllana: Po shifni, unë kam pasë këtu vajzën e axhës këtu të martuar ka qenë me profesor. Profesor e ka pasë burrin. Edhe e di kur vinte në Shkup ajo pa ferexhe, në atë kohë '47- '48- '49 gjithmonë, edhe unë s'kam qenë përpara në Prishtinë nuk e dija veçse tregonte se shumica e femrave, jo shumica po ni pjesë pak ma t'përparune që janë ma përparimtare që po shkolloheshin edhe ferexhen po e heqin. Te ne çuditeshin njerëzit, "Si ashtu femrat pa ferexhe". Edhe erdhi koha, '48-tën m'duket, filloi aksioni për heqjen e ferexhes, madje '49-tën, mirëpo në Shkup askush vetëm... madje edhe mësueset tona vinin në shkollë me ferexhe ato që ishin, për shembull, Nafije Qerkezin unë e kam pasë mësuese vinte me atë, peçe i thonin, e në shkollë e hiqte punonte mandej kur kthehej në shtëpi prap e vendoste ashtu shkonte.

Kaltrina Krasniqi: Si, a mundeni me na shpjegu si ka qenë ajo?

Ajtene Pllana: Si ka qenë ferexhja, ka qenë ni fund i zi, ni fund i zi pak më i gjerë jo ashtu i gjerë pastaj ka qenë ni pelerinë, ni pelerinë me gjithë kët' pjesën e naltë të kokës. Ma s'pari e veshnin fundin, pastaj ajo peçja që ishte ishte një si zarë ashtu ndonjëra më e holl ashtu, ndonjëra më e plotë ashtu. Ato më t'hollat që ishin ma shumë dukeshin jashtë po zakonisht t'rejat ndonjë femër që ma moderne që ishte i mbante ato. Nënata tona jo, ftyra fare nuk i dukej kështu ishte kjo pjesë {shpjegon me duar} edhe pastaj ajo pelerina kshu e lidhte përfundi edhe mandej mbështilleshte kështu ajo deri këtu {tregon me duar} bash e gjanë ashtu edhe ashtu visheshin.

Kaltrina Krasniqi: Ngjyra, çfarë ngjyra ka pasë?

Ajtene Pllana: Ngjyra ka qenë kryesisht e zezë, vetëm me të zezë. Çarçafi ka qenë gjithmonë i zi. Kam pa dikund tjetër në Bosnje me vija bardh edhe kaltër edhe... nëpër filma se s'kam qenë vet atje. E ke ne me të zezë e kto femnat ma moderne që kanë qenë, ato nuk kanë mbajten ferexhe kështu si tonat, si nëna ime, si shumica e grave, po ato kanë mbajt ni mantil t'bukur ashtu zakonisht. Çorapet e holla, këpucat ashtu, sandale ose kpuca t'mira edhe nalt atë pelerinën që thashë. Ate e kanë pasë fare të shkurtë vetëm e kanë lidh në kokë pak {tregon me duar}, a këtë peçen shumë t'hollë, shumë t'hollë. Sidomos ato femra që ishin shumë të bukura përfundi atij zari dukeshin edhe njerëzit shikonin. Aty ishte puna që duheshte... po femnat e reja, kemi pasë në lagje disa femra ashtu t'reja kurrë nuk kanë dalë vetëm në rrugë po na merrnin neve vajzave që ishim nga dhjetë vjet, nëntë vjet, tetë vjet bashkë me to me shku dikund. Se nuk bon a din, nuk bon e reja me dalë vetëm ose me vjehrrën, ose me ndonjë grua tjetër. Në qoftë se nuk ka ndonjë fëmijë e merrnin, ndonjë fëmijë pak më t'rritun tetë-nëntë vjeçar.

Kaltrina Krasniqi: Në çfarë moshe? N'çfarë moshe?

Ajtene Pllana: Në çfarë moshe? Po nana jem thoshte dymbëdhjetë vjet kur i ka pasë është mbulu, ashtu dhjetë-dymbëdhjetë si t'fillon vajza pak t'zhvillohet mbyllen. Unë (qeshë) njëherë u murrëm vesh vajzat e mahallës secila me e marr ferexhen e nanës t'vet edhe t'i veshim edhe t'dalim në rrugë edhe ishim nga dhetë vjet. I veshëm secila pesë-gjashtë vajza edhe dulëm në rrugë, nuk kalum as dyqind metra, "Kuku çka me ba tash, po na vjen turp në rrugë t'i hiqnim" (qeshë) edhe ishte mosvet çfarë ashtu. E nëna ime ka qenë hafëze ka kry, domethanë, përmendsh bashkë me vëllaun e vet në

dymbëdhjetë vjeçare është bo hafëz. Edhe jo babën e ka pasë imam e jo ashtu edhe kur doli puna me e hek ferexhen ishte shumë kundër, “Si do t’dal une?” Edhe baba n’burg. Mirëpo, me vite u mësuan.

Në pleqëri kur ishte nana shumë e sëmurë ishte 96-97 vjeçare erdhën disa nuse të ndërtesës aty në Shkup ta shohin. Edhe secila kto tash që po mbyllen, të mbylluna ashtu, edhe ndejti nana folën bisedun, “Pse...” tha, “çikat e mija jeni mbulu kështu? Nuk është koha” thotë, “Tjetër ishte në kohën tonë”, ato veç shikonin thonë, “Kjo hafëz”, “Unë jam hafëz. Jam shumë ashtu...”, edhe e di... edhe kështu nëna ime mundohet t’i bind edhe thotë, “Tjetër ka qenë në kohën tonë” edhe thotë, “e di krejt çka do t’thotë pse mbahet ferexhja edhe... Por tash janë ndrru kohnat”. Thotë, “Unë jam fetare edhe gjithë ditën jam me Kuran në dorë, po ju t’reja jeni”, po, jo e kanë ni bindje ashtu se...

Kaltrina Krasniqi: Çka është hafëz?

Ajtene Pllana: Hafëz është ajo e cila e ka mësuar Kuranin përmendësh. Nana derisa n’fund, derisa vdiq e dinte Kuranin përmendësh. Merre me mend, e mësojnë Kuranin arabisht, arabishten nuk e dijnë. Në qoftë se e dijnë gjuhën është diçka tjetër, mirëpo nana e ka pasë gjyshin e ia ka spjegu të gjitha ato si shkojnë ato ashtu edhe dinte ajo kuptonte a din. E turqishten e vjetër e ka ditë, osmanishtën edhe në atë gjuhë edhe ka shkru edhe ashtu...

Kaltrina Krasniqi: A keni qenë ju fëmijët religjioz?

Ajtene Pllana: Religjioz? Religjioz, ku religjioz? (Qeshë) Jo. Religjioz do të thotë në qofëse shkon edhe... vëllau i madh... vëllau i madh, se ka qenë në kohën e okupacionit, është çelë shkolla... bugarët kanë çelë shkolla turke, ka shku edhe aty kishte mësuar edhe arabishten. Arabishtën, jo gjuhën, por shkronjat arabe, turqishten e vjetër e ne jo. Në shkollë nuk kemi shkuar, mirëpo ato elementare të islamit që janë natyrisht që i kemi ashtu. Si vajzë e re edhe mbajsha ramazan mandej jo. Kur u martova, fëmijët, sende edhe e lash. Nënës i vinte pak keq, po edhe nëna na mësonte lutjet kështu kur të flen, kur të bjen të lutem, kur të ulemi me hangër, kur të ngihemi kështu. Ma shumë nana na ka edukuar ashtu, t’jemi fëmijë t’mirë, t’jemi të ndershëm, t’mos bojmë ato, t’mos bojmë këto, gjana.

Ajo kishte dëshirë ma tepër mirëpo kohnat ishin atëherë të tilla që as nuk kishte shkolla fetare. U hap një shkollë na çojnë neve, nana, mu edhe motrën nja dy muj a s’di sa, pastaj e lamë edhe thoshte, “Qe ju çova edhe nuk bot’ kurgja”, more thojsha, “Çka ajo u ulshim në tokë ajo rrinte...” ajo mësusja atje e kishte ni shtagë nja dy-tri metra, dy-tri metra edhe me bo dikush me lëviz pak veç... edhe nuk kuptonim asgjë arabisht, paradite shkonim aty nja dy ore mandej masdite në shkollën fillore edhe mandej e lamë, dy shkolla përnjëherë. Po natyrisht se e kam... jam edukuar në atë fe, a po kupton, ato kryesoret që janë i mbaj. Megjithëse nuk e urrej kërkënd çfarëdo feje që t’ketë, nuk është...

Kaltrina Krasniqi: Është një moment në librin e juaj kur folni për fëmininë e hershme edhe për varfërinë që ka ekzistuar mënyrë mas Luftës të Dytë Botërore, mënyrën qysh fëmijët janë ushqy nëpër menza t’qytetit, a mundeni me fol pak ma zgjanimisht për atë moment mas Luftës së Dytë Botërore?

Ajtene Pllana: Po, po, po. Shih më duket se dikah ka viti ‘48 ato pasi u ndanë prej Bashkimit Sovjetik pak sikur filluan gjërat të lëvizin, a din, në... mendoj në kuptimin pozitiv, a din, sidomos rreth fëmijëve. Nëpër lagje... në lagjën tonë për shembull, ka qenë ni restorant edhe e ka pasë ni oborr shumë t’madh si hanë ka qenë ni pjesë, aty u hap një restorant ku fëmijët shkonin edhe merrnin nga një copë bukë, pa t’holla ishte. Buka ishte e thatë, vetëm bukë. Bukë e bardhë nga një copë kurgjë tjetër. Tek atëherë kur

shkum, kur fillum të shkojmë në ato, e pamë se gjithkush, jo vetëm familja ime që vuajmë po gjithkush vuan për atë elementaren, për një kafshat bukë, edhe para se t'shkonim në shkollë shkonim atje merrnim edhe askush asgjë s'paguante.

Pas një viti ashtu e banë si një kafiteri ka qenë, zinte shumë fëmijë, e hynim aty e na jipnin ndonjëherë na jepnin nga dy copa bukë bile ndonjëherë edhe me marmaladë, ndonjëherë edhe me ndonjë kaçkavall ose diçka. Mirëpo nuk kishim të drejtë jashtë t'i nxjerrnim, a gjithkush mundoheshte diçka me nxjerr edhe jashtë me çu në shtëpi. E një gru rrinte te dera e na kontrollonte kështu mos kemi bukë mos kemi fut dikund në trup edhe me na zanë turproheshim (qeshë) por kur i çonim në shtëpi, a din, ishte sadopak... për shembull, dy-tre fëmijë shkojnë prej një shtëpie hajnë bukë.

E çka ka qenë ma e mira, nëpër shkolla u hapën mensat. Shkolla jonë kishte mensë shumë të mirë edhe çdo ditë kishte supë, gjellë me mish e një ditë tash kur bisedova me motrën thashë, "Si kishte hesap, shteti llogari, të gjitha ato çdo shkollë të kishte edhe mensën?" Tha ajo, "Ka qenë ndihmë prej Shteteve të Bashkuara për me ushqy fëmijët". Edhe një drekë e mirë aty ishte një punë shumë e madhe për një familje apo në qoftëse ke tre-katër fëmijë në shkollë. Po du me thanë, luftonim në atë kohë për elementaren, a po, kur nuk ki ushqim të mirë në shtëpi. E ata që kishin lidhje, kishte edhe njerëz që jetonin më mirë ose në punë dikund edhe atëherë ata gjindeshin më mirë se sa dikush që s'kishte kushte.

Kaltrina Krasniqi: Për çfarë arsye ka shku baba juj n'burg?

Ajtene Pllana: Baba jem ishte në burg për shkak të dajës, që e mbajti dajën dy javë. Edhe baba jem ka qenë shumë dorëshlirë, njeri me mujt prej trupi teshat me ia dhanë dikujt edhe e kishe ndihmuar... daja e kishte pasë organizatën në Shkup, arsimtarët tanë, arsimtarët e shkollës tonë kishin qenë anëtarë të organizatës Nacional Demokrate të Shqiptarëve edhe baba... shumica... shumë nëpër male kishin mbetur në atë kohë, ballistët shqiptarët që kanë ashtu... edhe baba u kishte ble 600 palë opinga aty në mal me iu ndihmu edhe t'holla kishte dhanë, se ka pasë t'holla edhe dajën e mbajti.

Ne nuk dinimin. Daja as babës, as nanës time nuk i kishte treguar se ku po del, çdo mbramje dilte, vinte... ka qenë shumë pedant, shumë njeri i pashëm. Vinte e rrunte ai berberi edhe shkonte. Nëna po i thoshte, i thonte se unë s'kam dëgjuar, "Ku po del kështu për natë Ibrahim?" Thotë, "Ashtu dhambi, dhambët s'i kam n'rregull e po shkoj me i rregullu", edhe nana ashtu ka mendu edhe në natën e bajramit në '46-tën erdh një kerr në shtëpi, një kerr me kuaj. Dajën e veshën me tesha t'vjetra t'fshatarve me një plis me diçka edhe e shtrin n'atë kerr edhe shkoi. Kjo ishte hera e fundit që e pamë dajën ishte nata e bajramit, n'ramazan, domethanë, nata e bajramit. Kishte shkuar në fshatrat e Kumanovës, aty e kishin mbajtur fshatarët një kohë, sa? Nuk di. E pastaj në Greqi. Prej Greqisë, në Gjermani edhe prej Gjermanisë në Australi derisa vdiq në '97-tën, në '97-tën vdiq.

I kishin propozuar të shkojë në Amerikë atje, mirëpo me një kusht, kishte... paska pasë një ashtu... kishin organizuar shtetet e jashtme s'di aty nuk, me një desancë me parashuta ashtu në Shqipëri kundër Enverit, komunizmin ashtu, edhe këta me qenë, daja jem e disa të tjerë kta kishin thanë, "Ne nuk luftojmë me vllezërit tanë, pa marrë parasysh se janë ata komuniste nuk mundemi". E atëherë i kanë thanë, "Nuk ke të drejtë të shkojë në Amerikë. Zgjedh ku?" Në, në Itali nuk ishte pranuar se shumë afër, atëherë UDB-a shumë ka ba asi, edhe kishte shku në Australi atje është martuar me një

angleze, ajo është {tregon me dorë nga fotografia} edhe fëmijë s'ka pasë vdiq atje. Deri në fund ka qenë shumë aktiv shumë ashtu, qe kështu.

Pjesa e Dytë

Kaltrina Krasniqi: Tregom pak për vizitat që ja keni bo babës n'burg, qysh ka qenë?

Ajtene Pllana: Po, baba në fillim... në fillim baba ishte në burgun hetues në OZNA ashtu ishte. Ai ka qenë... kishte qenë burg shumë i rëndë (qanë) shumë vonë kam kuptuar vajza, motrës i kishe treguar babai, mu s'më ka treguar asnjëherë (qanë). Se baba vunte, veshkët i dhimbshin, por nuk na tregonte kurgja. Derisa ka qenë në hetime, po e mbulojkan me një jorgan e mandej po e rrifkan me dru e me sende dhe aty iu kanë shtyp veshkët me vite t'tana.

Aty nuk kishim të drejtë ta shohim, vetëm ushqim t'i çojmë. Ni ditë nëna pa në ca enë të aluminit që çonte nana në burg ushqim, ka shkru diçka ma shkronja arabe, "Fatush, a jeni mirë? Fëmijët? Kqyri fëmitë", a din, qeshtu disa fjali. Pastaj na blejshim gjithë t'reja, a din, edhe nana shkrunte prapë arabisht, "Mirë jemi mos u mërzit".

Kaltrina Krasniqi: Edhe çka ndodhi mandej me ato pjatat?

Ajtene Pllana: Edhe për fat nuk i kanë zbulu se t'kishin zbulu mos vet. Baba shkunte diçka, nëna përgjigjej edhe kështu mirreshin vesh, se përndryshe nuk kishin qasje kështu, për takime nuk kishin të drejtë. Kjo një kohë... baba mbeti një kohë të gjatë në burgun hetues. Në ndërkohë para babës u zbulua Organizata Nacional Demokratike, aty ku ka qenë edhe daja, por daja veç pat' shkuar. Atëherë i burgosën nja tre-katër mësues tanë, zotëri Azem Oranën, zotninë, si e ka emrin tashi ia harrova momentalisht edhe Mahmut Dumanin nga Shqipëria. Ata dytë ishin, njëri ishte i Prishtinës, Hasan Bilalli, domethanë, Azem Orana, Hasan Bilalli edhe zotni Mamut Dumani, prej shkollës fillore, prej klasëve t'nalta, nuk e di. Edhe '47-tën u mbajt ma herët se babën tim, ishte grup tjetër, baba ishte një grup tjetër kështu ma asi... këta ishin kryesorët.

Kështu... atë mësuesin e vllaun tim zotrinë Azem Muranën e dënuan me vdekje. Ishte i martuar, mendoj pas një jave si dhëndërr të ri e burgosën e dënuan me vdekje. Zotëri Azem Bilallin e dënuan me njëzet vjet burg, ishte mësuesi i vëllaut tim t'dytit, e atij i dhanë njëzet vite po i mbajti nja dymbëdhjetë vjet. Edhe dajën tim e dënuan me likuidim ashtu, por ai nuk ishte aty, në mungesë. Nuk ishte vetëm Partia e Shqiptarëve edhe turqit kishin një parti ashtu "Yücel" quhej edhe aty e mbaj në mend se njërin, babën e një shoqe sime që mandej u bë pianiste, edhe babin e saj e likuidun.

Kaltrina Krasniqi: Çfarë organizate ka qenë kjo?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Çfarë organizate ka qenë kjo?

Ajtene Pllana: Nacional Demokratike Shqiptare.

Kaltrina Krasniqi: Kjo ka qenë parti politike, organizim politik, a dini diçka ma shumë rreth organizatës a jo?

Ajtene Pllana: Po ka qenë organizatë për bashkimin e tokave shqiptare, kundër komunizmit, nuk kanë qenë komunist ata, kështu.

Kaltrina Krasniqi: Tash po vazhdojmë prapë me jetën e juaj, mandej ju e përfundut Normalen edhe çka ndodhi mandej?

Ajtene Pllana: Përfundova Normalen edhe mandej u martova. Më doli kismetin në Prishtinë. U martova këtu.

Kaltrina Krasniqi: Me kënd u martut?

Ajtene Pllana: Me profesor Shefqet Pllanën. Ishte albanolog, mirrej me shkencë me studimin e folklorit, pasaj më vonë i kreu poststudimet edhe doktoroi në letërsinë popullore, jipte...

Kaltrina Krasniqi: Ku e takut?

Ajtene Pllana: Ku e takuat? Është shumë interesant (qeshë), nuk do t'besoni. Ne ishim në '58-shen në sallën e... në mensën e studentëve të Normales, në binë përgaditeshin... patën ardhë prej Radio Shkupit të inçizojnë, ta inçizojnë korin tonë edhe disa këngë. Ishte ni udhëheqëse, ni Parasqeva, s'di mbiemrin nga Shqipëria ishte, ishte edhe spikere shumë e mirë e Radio Shkupit në gjuhën shqipe edhe aty inçizunë kangët për radio, kori. Në ndërkohë po shoh, erdhi ni mësues që unë e njifsha, ishte i martuar me një shoqe timen. Me një njeri tjetër dhe erdhën aty edhe po shoh u ulën. Askush nuk ishte në sallë vetëm ata të dy edhe kur u kry unë zbrita, kështu anash ishin shkallët, zbrita për me shku edhe e ktheva kokën i shikova ata.

Kur po shof njëri i ka hap sytë edhe po m'shikon unë e ktheva kokën në anën tjetër. Edhe është interesu për mu kush është, tek është? Edhe mbas, diçka puna ime u përzi edhe ashtu në gusht erdhi vajza e motrës vet ke une më tregoi për të, thashë, "Mirë ta shof". U takuam, mbas, pas një jave u fejuam. Pas dy jave u martuam tri jave (qeshë). Është çudi!

Kaltrina Krasniqi: Edhe mandej prej Shkupit erdhët në Prishtinë?

Ajtene Pllana: Prej Shkupit erdha në Prishtinë. Po ishte ashtu shumë njeri i mirë, shumë ashtu, shumë bashkëkohor ishte, shumë ashtu... kishte një kulturë të gjanë, një ashtu... ishte babë i mirë e krejt e kështu. Mbeta në Prishtinë.

Kaltrina Krasniqi: Tregomani tash atë momentin kur e keni ndrru qytetin, domethanë prej Shkupit në Prishtinë. Çfarë Prishtine e keni gjetë?

Ajtene Pllana: A dini çka më pengonte ma s'shumti? Në atë kohë, këtu gratë në shtëpi krejt rrisin me dimija ose kule, kule iu thojshin. Ishin ashtu si dimija, por jo ashtu t'gjana, në Shkup ke ne nuk veshin dimija kërkush. Qytetarët nuk veshin. Bile edhe të fshatrave që vinin nuk mbanin. Ajo më pengonte edhe vajzat, vajzat e reja jo pantallona në atë kohë, por jo larg me dalë por në lagje, në shtëpi gjithë me ato kule. Mu m'shkojshin nerva shumë, shumë m'pengojshin. Thojshin, "Ama shumë nxet, me këto shumë mirë".

Prishtina... babës i thoja, “Eja bre, eja pak ma shpesh në Shkup”,¹ ka qenë shumë pedant, “Jo çika jeme, si po shkeli në rrugë krejt n’baltë meniherë”, s’kishte as rrugë të asfaltume. Këta prishtinasit shumë vujnë për atë Prishtinën e vjetër, po me qenë t’i kenë sytë e mija, e mi t’shofin, as Shkupi... edhe Shkupi ka pasë ashtu, po ka qenë pak ma ndryshe prapë, po çka më...

Kaltrina Krasniqi: Në cilën lagje erdhët për herën e parë me jetu në Prishtinë, n’cilën lagje?

Ajtene Pllana: Këtu në oborr kishim shtëpinë e vjetër pastaj e ndërtoam ktë. Prej kur kam ardhë jam këtu. Edhe ni kohë kur filluan njerëzit të ndërtojnë shtëpia edhe neve e vendosëm, “Hajde të bajm e po shkojmë diku ma larg”. Mirëpo llogaritsha unë e kam shkollën afër, shkolla e muzikës është afër, vajzat në shkollë fillore këtu, gjimnazi këtu, i thoja, tregu afër, “Në qoftë se të zgjedhin deputet qe ku e ke Këshillin Ekzekutiv” (qeshë) talleshim kështu, krejt afër. Mu m’konvenonte se katër fëmijë, apo, isha e vetme. Mirë u adaptova ashtu. Ma shumë me angazhime ashtu në shtëpi, me fëmijë, mësojshin mirë, krynë shkolla të larta edhe ashtu shkoi.

Kaltrina Krasniqi: Sa fëmijë i keni?

Ajtene Pllana: Katër.

Kaltrina Krasniqi: Tregomni pak për fëmitë e juj edhe jetën familjare?

Ajtene Pllana: Po shifni, vajzën e madhe e kam pianiste ishte profesoreshë në fakultet këtu. U martua me një djalë shumë të mirë mjek. Mirëpo ai çmendeshte për Amerikë të shkoi, të shkojë në Amerikë edhe u bind edhe vajza ime. Megjithëse, nuk ka pasë dëshirë të shkojë atje. Këtu kreu ato, jepte mësim vajza në fakultet, në Akademinë e Muzikës. Në Moskë kreu specializimin në Tchaikovsky, pastaj kishte shumë shanca për përparim, për ashtu... nëpër Jugosllavi, mbante koncerte për 200 vjetorin e Revolucionit Francez, ishte në Paris mbajti koncert. Shkoi atje, tash jep mësim në një fakultet i ka dy djem.

Vajza e dytë... vajza e dytë ajo arkitekturën e kreu jeton në Londër është shumë e suksesshme, shumë ambicioze, mirë i ka punët. Ajo është madje iniciatore për librin. Se unë fillova vetëm t’i shkruaj kujtimet e mia prej fëmijërisë, e prej... ajo, “Jo, nana...” thotë. Dikur kur e pa krejt, “Nana shumë t’mira, ne do ta bajmë libër”. Them, “A je n’veti, çfarë libri?” Unë thashë, “vetëm juve t’ja u lo ni kujtim”, “Jo, jo do ta bëjmë, do ta bëjmë”, ashtu. Edhe kjo e treta, Arta, ajo e ka krye albanologjinë punon këtu n’qeveri dikund. S’di çka është, s’i di ato punë. Edhe djalën e kam, ai e kreu në... poststudimet në Londër për producent, që po bahen shtatë-tetë vjet po nuk ka punë, po punon poshtë e ka çelë ni studio, qe kështu.

Kaltrina Krasniqi: Mandej këtu keni fillu meniherë me punu apo?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Mandej këtu keni fillu meniherë me punu apo?

Ajtene Pllana: Po, po.

Kaltrina Krasniqi: N’cilin vit keni fillu edhe n’cilën shkollë?

¹ Folësja mendon të thotë në Prishtinë, ndërsa thotë Shkup.

Ajtene Pllana: Une, në vitin 1960 fillova për herë të parë, jo m'falni '58-shin kur u martova pas dy muajve u pranua në shkollën "Emin Duraku".

Kaltrina Krasniqi: Ku është kjo shkollë?

Ajtene Pllana: Është këndej përtej pazarit, ajo pjesa ashtu... aty punova një vit edhe pastaj më lindi vajza e madhe Teuta. Një vit paqzova, duheshte të mësohem si nënë e re të kujdesem për vajzën, e në '60-ten u punësova në këtë shkollë dhe deri në pension punova ktu në këtë shkollë.

Kaltrina Krasniqi: N'cilën shkollë?

Ajtene Pllana: "Elena Gjika" dikur ishte "Vuk Karadžić" pasi që u pensionua unë pas ndrrimeve e mori emrin "Elena Gjika".

Kaltrina Krasniqi: Tregomni pak për atmosferën n'skollë, kolektivin? Duheni me e pasë parasysh që njerëzit nuk e njohin historinë e kësaj shkolle as ksaj lagje, kështu që duheni pak ma detajisht me spjegu.

Ajtene Pllana: Po shikoni, (qeshë) kur u punësova këtu gjithmonë bëja ashtu krahasime me shkollën time "Iliria" në Shkup, se shkollë fillore ajo shkollë fillore kjo edhe i matsha. Ajo shkollë ishte... për ditët e sotme është fantazi, asi shkolle, por tërmeti e prishi për fat të keq. Kur erdha këtu, kjo shkollë e vjetër, ato drrasat t'kqija, në klasë me dru nxeheshte. Vinte pastruesja orë e çast binte dru e sende mirëpo kishin pak fëmijë në gjuhën shqipe, mendoj, më tepër kishte fëmijë serbë, paralele serbe se sa shqiptare, pastaj u rritën paralelet tona. Mirëpo kishte shumë rregull, rregull kishte, pastër rrinte.

Mbas çdo pushimimi... mbas çdo pushimi kur hinim në mësim pastruesit i fshinin koridoret krejt, pastërt mirë. Kushtet ishin minimale për punë, s'kishe banka, të vjetra, çdo gja e vjetër, po në krahasim me Shkup nuk... në Shkup kishte tjera edhe Normalja kishte tjera kushte. Mbanim, për shembull, mësimë nëpër kabinete. Mësimi kabinetik mbaheshte ndash biologjia, ose, ose çka di fizika, kimia kto edhe gjuha shqipe bile si bibliotekë ishte ni klasë. E këtu nuk kishte asi kushte, jo.

Çdo vjet tri-katër herë prej viteve të '60-ta e di që bëhën disa rregullime ashtu rrënjësore, mendoj rrënjësore. Mirëpo, a është faji ke ne arsimtarët a është ke fëmijët apo vetëm ashtu mosinteresimi? Tash nuk e di si është sepse sivjet e kanë rregulluar përsëri. Mirëpo kemi pasë kolektiv shumë të mirë, besoj se vazhdojnë edhe më tutje. Në atë kohë ka pasë mësues tepër, mësuese tepër të mira.

Nuk ishim shumë, ishim ndoshta shtatë a tetë mësuese, nantë, por ka qenë Myzafer Hatipi, një arsimtare që mësuese e ciklit të ultë që ka kryer në Shqipëri, mandej ishte Lirie Tanefi një zonjë e moshuar nga Shqipëria korçare edhe ajo, kishim Nyvebetë Drinin ka qenë një mësuese e shkëlqyer, ka qenë Edibe Pula ato gjeneratat e vjetra për to po flas, Fahrije Shita matematikë jipte, shumë e përgaditur për lëndën e vet, mandej disa mashkuj ata që kanë qenë dy a tre ma tepër s'kishte. Mandej mësueset e ciklit t'ulët po ashtu ishin Nyvebeti, Edibja kanë qenë në ciklin e ulët mandej edhe unë u shtova aty edhe qishtu kishte...

Jemi... një ditë po bisedonim, jemi shumë kshtu krenar çka ka diçka, disa intelektualë që janë kështu t'njoftun si, si, si ashtu që peshtojnë që kanë një ashtu... kanë dalë prej shkollës tonë. Edhe Pupovci ka qenë nxënës i shkollës tonë edhe ky djali, gjithë ia harroj emrin, "Kohën Ditore" që e mbanë...

Kaltrina Krasniqi: Surroi.

Ajtene Pllana: Surroi ka qenë shok klase me vajzën time. Sa mjekun, sa... edhe nxënësit e mi kanë mbri shumë, është ajo... i kam tre, katër nxënëse doktora t'shkencave edhe djemtë edhe ashtu krenohemi. Mandej mësueset tjera shumë, shumë kuadrot, ato kuadrot e para që kanë dalë edhe tash ata po vazhdojnë. Ka traditë shkolla, është shkollë e mirë megjithëse edhe shkollat e tjera me siguri, po unë s'kam pasë qasje në to, por po flas për shkollën tonë. Ka pasë kuadrot e mira edhe nxënësit kanë qenë shumë të mirë.

Kaltrina Krasniqi: A ju konvenojke me e pasë shtëpinë kaq afër prej shkollës?

Ajtene Pllana: (qeshë) Pat' ardhë njihere ni shok i bashkëshortit tim edhe tha, "Ku po punoni zonjë?" thashë, "Në këtë shkollën këtu", "Si i ke punët me drejtorin?" Thashë, "Mirë", tha, "Pse nuk po e lut këtu poshtë me ta pru klasën" thotë, "mos shko deri atje". Jo nuk ishte shumë interesant. I merrsha lakmi shoqeve t'mija kur kryheshte mësimi kah ora 4:00 ose kur ishte dita ma e gjatë, dilshin edhe hishin, jo nëpër dyqane me ble diçka, jo ndonjë send. Unë duheshte të vrapojë menjëherë se tre fmi, menjëherë djali ma vonë më lindi dhe duhej jem në shtëpi. Mirëpo, kur binte shi ose borë ose diçka ato... unë meniherë... mandej e merrsha, e kisha ni shoqe t'mirë, "A mbrive në shtëpi?" "Kuku", tha, "mezi" thashë, "Unë e piva çajin", (qeshë) merrshin lakmi, jam afër. Ashtu kur ke fëmijë t'vegjël është mirë me e pasë ashtu, po kur janë pak ma t'rritun pak del edhe shëtitë edhe sheh diçka. Qe kështu jeta.

Kaltrina Krasniqi: Çfare, çka ka keni mësuar t'u qenë mësuese e ciklit t'ultë? Çka ju ka dhanë ai vokacion?

Ajtene Pllana: Çka, çka të them... tash mos të vjen ajo si lavdratë diçka po, me i dashtë fëmijët, me iu besue, me iu.... me punu që të kenë me e ba mësimin ashtu që t'interesohen, të kenë ashtu, të kenë interesim për atë edhe ajo është. Mendoj, aty që kam ndi kënaqësi edhe kam pasë sukses ashtu. Unë mendoj me fëmijë... ne jse ne jemi njerëz gjithmonë nuk mundemi çdo herë me qenë ashtu, mirëpo duhet, mësuesi duhet të ketë shumë dashuri, shumë ta merr punën seriozisht, jo vetëm të punoj për një rrogë, për një ashtu. Edhe fëmija, fëmijët janë të etshëm.

Së paku në kohën kur ne mësonim, kur punonim ne janë ma të etshëm për dituri, për diçka t're edhe gjithmonë me e bo mësimin ma interesant, jo vetëm ashtu në mënyrë klasike, "Hajde sot e kemi këtë, këtë". Unë për shembull, kurrë nuk kam hi në klasë pa bisedu dy-tre minuta, dy-tre minuta çka keni ba, çka është ba ajo, kjo relaksohen fëmijët. Se kur hin meniherë, "Qitni detyrat e shtëpisë", ajo është një disi, si të them, një presion ashtu e kështu pak e merr si t'përditshme, si argëtim, si ashtu edhe mandej..

Gjuhës i kam dhënë shumë rëndësi, shumë. Bile, kur m'u rritën fëmijët, pastaj librat e fëmijëve t'mi, bibliotekës, çka kam pasë dy-treqind libra ndoshta ia dhashë bibliotekës t'shkollës e tjerat ia u shpërndajsha fëmijëve. Tash them a bona mirë, a jo? Po mirë fëmijët e mi veç u patën rritë edhe qe kështu.

Kaltrina Krasniqi: Prej kësaj perspektive p'i bjen që ju jeni në Prishtinë gati 50 vjet?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Prej kësaj perspektive...

Ajtene Pllana: Po?

Kaltrina Krasniqi: Po i bie që ju jeni në Prishtinë gati 50 vjet?

Ajtene Pllana: 60 vjet.

Kaltrina Krasniqi: 60 vjet?

Ajtene Pllana: Po.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka ndryshu ky qytet për juve?

Ajtene Pllana: Po ka ndryshu shumë. Ka ndryshuar shumë. Po çka ka ndryshuar edhe mentaliteti edhe krejt po... s'kisha ditë çka të them. Kam shumë çka me thanë edhe (qeshë). Nuk e di a është ajo nostalgji për kohën e përparme ke njerëzit kur janë në një moshë apo... se neve na duket kur bisedojmë me t'moshës tem se ajo kohë ka qenë shumë ma mirë atëherë edhe fëmijët, fëmijët kanë qenë ma t'dëgjushëm, ma kanë pasur ashtu... arsimitari ka pasur ma tepër respekt, e tash diçka... Shifni, prindët e tashëm, unë shoh shumicën tash nuk është ajo kritikë, mirëpo thua se shumë ma me rëndësi është që fëmija vetëm të jetë bukur i veshun, i rregullun ashtu nuk është. Me fëmijë duhet të punohet shumë prej ditës t'parë në qoftë se dëshirojnë diçka të arrijnë.

S'i të fitojnë shprehje, shprehitë pune, mos u tremb prej atyre. Unë kam punu shumë me fëmijët e mi. Megjithëse, kanë qenë bajagi të zgjuara kshtu po kam qenë... disi obligim kam pasë shumë të punojë me to mandej fëmija e merr... Kur po shof diçka me prindër kur po lexoj, kur po bisedoj, po thojnë, "Nuk po punon sa duhet". E duhet me ia kriju jo vetëm kushtet, kushte ka sot nuk janë sikur dikur, mirëpo me fëmijë ki me ndejt s'ka shëtitje, s'ka dalje nëpër *vrc, vrc, vrc* {onomatope} në ndeja, me shoqe e sene, me fëmijë vetëm duhet punë, punë, punë. Derisa ta kuptoj fëmija esencën, çka është, pse po shkon n'shkollë, çka duhet të dijë. Mirëpo edhe prindërit nuk janë aq fajtor, as fëmijët sa është teknologjia e sotme.

Fëmija dy vjeçar me... nejtse kjo është dukuri gjithkund nuk është vetëm ktu ke ne. I gjejnë gjanat e gatshme edhe tanë ditën n'vend se të lexojnë ndonjë libër me telefona me sene. Isha në Londër vitin e... parvjet kur isha shoqja ime e ka, vajza ime e ka një shoqe është arkitekthe edhe fëmijve t'vet gjatë tanë javës nuk iu lejon as televizion, as ndonjë emision, veç t'caktune kur duhet me e pa ose me telefon ose me Ipad ose me diçka s'ka. Thotë, "T'shtunen munden me ba çka t'dojnë me lexu, me kqyr me ashtu... A ditëve tjera jo", Ka sistem, ka rregulla. Tani ata fëmijë mandej janë ma kështu ma të suksesshëm. Mendoj, ashtu po mendoj, s'e di.

Pjesa e Tretë

Kaltrina Krasniqi: Na jemi tu u mundu, përmes rrëfimeve individuale me rikujtu qytetin qysh ka qenë, sepse për 60 vjet sigurisht edhe ju e dini sa shumë ka ndryshu, sa shumë gjana që kanë ekzistru nuk ekzistojnë ma. A mundeni pak me mendu edhe me na dhanë ni paraftyrin çfarë qyteti ky ka qenë, për juve?

Ajtene Pllana: Prishtina?

Kaltrina Krasniqi: Po.

Ajtene Pllana: A e dini si qyteti... qyteti si qytet, në qoftë se e kam krahasu me Shkupin nuk m'ka pëlqy t'drejtën me t'thanë, nuk... Mirëpo, çka më pëlqente kishte shkolla mjaft në gjuhën shqipe. Ishte gjimnazi, Shkupi nuk ka pasë gjimnaz, mezi e hapi Normalen, ishte Normalja, ishte shkolla Ekonomike, ishte shkolla e natës që i thojshin me shku edhe në mramje, ishte Shkolla e Muzikës aty plot me fëmijë tanë, fëmijë shqiptar ajo shumë do t'thotë. E në Shkup vetëm ni Normale kurgjo tjetër, ni klasë vetëm tri vajza. Këtu plot, plot ajo mbante edhe ishte, ishte jo vetëm shpresë po taman e sigurtë se një ditë do kta, këta fëmijë do t'mbrijnë do t'ketë përparim.

Baba im kur vinte këtu ishte shumë arsimdashës. Edhe vet pse baba shkrunte shumë bukur, fliste shumë bukur, shkrimin shumë t'bukur thoshim, "Babë sa vjet shkollë ke pasë, ke msu?" Thotë, "Veç një vjet". "Pse veç një vjet ku ke mësu kështu të shprehesh..." nuk na tregonte si dukej vetëm fillorën e kishte kry ose diçka ma tepër po s'tregonte sa shkollë ka pasë. E kur në mëngjes, rrallë herë vinte, rrallë herë vinte, ama kur vinte ndonjëherë dy tre net me ndejt. Po del n'mëngjes kah ora tetë po vinte në shtëpi, mëngjes ma herët po del, "Ku ishte babush?" Thoshte, "A din çka? Po rri para sahatit aty edhe po i shoh ata fëmijë po shkojnë n'skollë në gjimnaz, krejt shqip po flasin" (qeshë) i bënte përshtypje se në Shkup nuk i ka pa, thojsha, "Aq po t'pëlqejnë?" "Si jo, do fmi t'mirë..." atij i kishin lanë përshtypje para pesëdhjetë e sa vjetesh e tha, "Do fëmi t'mirë po shkojnë n'gjimnaz me çanta n'dorë bukur t'veshun, t'pastërt m'u rrit zemra", a din, edhe mua më pëlqente.

Ishte teatri, e kemi pasë edhe ne teatrin, por në krahasim me Prishtinën, jo. Këtu jipeshin ashtu gjana të shkrimtarëve të famshëm botëror, kurse te ne diçka... çka hajde ma, ma, ma... se s'kishte artista, nuk kishte artista. Radioja ishte këtu në gjuhën shqipe në Shkup vetëm lajmet edhe ndonjë program muzikor edhe kurgjo tjetër. E prej atëherë dukeshte se... mandej universiteti u hap e të gjitha këto ishte përparim a po? S'ishte me rëndësi. Njerëzit i bajnë edhe rrugët edhe lloqin e hjekin edhe ndërtesa e sende, por duhesh kuadro me kriju, elan kishin për shkollim, për krijimin, për hapjen e shkollave t'nalta se ajo m'pëlqente...

Kaltrina Krasniqi: A shkonit ju në teatër e kinema këtu se n'liber tregon që keni shku n'teatër edhe n'kinema.

Ajtene Pllana: Unë kinemanë e kam dashtë shumë prej fëmijërisë me mujt kisha flejt në... një film e shifsha katër herë pesë herë edhe i disha krejt dialogjet. Unë mbaj mend shumë, prej fëmijërisë krejt sendet i mbaj në mend edhe m'pëlqente shumë. Ndonjëherë tregojsha në shtëpi, ndonjëherë s'tregojsha i gjejsha paret, lirë ishte kinemaja, dy dinarë, tre dinarë me hy i shifsha filmat.

Edhe këtu kemi shku shumë n'kinema me bashkëshortin vetëm se në teatër edhe në koncerte kemi shku shumë. Ai nuk ka qenë njeri i kafeneve nuk... s'ka dashtë nëpër kafene me shku kurrë. As nuk ka pi as cigare nuk ka pi edhe thoshte, "Jo..", e n'teatër e n'koncerte rregullisht kurrë s'i kemi lanë. Mirëpo, kur dilshim prej koncertit thoshte, "E grue tash shkohet në kafene nga një kafe me pi mbas, nuk shkohet në shtëpi mbas koncertit", "Hajt hajt" thojshim, "Në shtëpi se fëmijët i kemi" (qeshë) e sheh kështu, shumë... çdo pjesë teatrale, çdo koncert, ndaq klasike, ndaq argëtuese, populllore rregullisht kemi shku.

Kaltrina Krasniqi: N'cilat salla?

Ajtene Pllana: Zakonisht Kinema Rinia ku është, aty mbaheshin te Kinema Rinia, ato koncertet ma t'vogla ashtu jo të fëmijëve jo, në, në Shtëpinë e Armatës, ka qenë Shtëpia e Armatës. Pastaj në teatër ky teatër ka qenë. Nji kohë ka qenë edhe skena e vogël, skena e vogël mbaheshte në koridorin e teatrit, a din, ku... foajeja ku është, aty bile e kanë pasë këtë "Pjata e drujtë" nji pjesë shumë të mirë ashtu, në rreth e përçark ishim, pak nuk zinte shumë spektatorë e qishtu. Mandej koncertet ato janë mbajt ato akordet e muz... ashtu "Akordet e Kosovës" aty vlonte qyteti.

Nji javë përpara vajzat e mia babës t'vet, "Baba, gjej edhe për neve bileta, fëmijët e tjerë po shkojnë", "Ku t'gjejë unë?" Hajde, ndonjëherë iu gjejshim, ndonjëherë jo. Zakonisht mbaheshin në një sallë ma t'madhe kështu, qe kështu ishte. Kishte nji gjallni a po, shpesh vishim prej Shkupit këtu për me pa diçka. Shkupi kishte, por shumë pak, shumë. Jeta kulturore nuk zhvillohej në krahasim me maqedonasit, ata kishin edhe kuadro edhe mundësi. Unë e di fëmijë isha në klasën e shtatë fillore më duket kur filluan të ndërtojnë Shkupin, Teatrin e Pakicave Kombëtare në pazar. A e dini ku është Bit Pazarit, aty teatri po a shkohet, teatri lyp ni vend ma... në pazar teatri, aty tezgat, specat, domatet shiten, aty teatri, nuk shkon sot e kësaj dite. Tash po e renovojnë për s'dyti a për s'treti bukur e kanë bo, por n'pazar. Diçka shumë më pengon ajo prej ditës t'parë m'ka pengu.

Teatri Maqedon ka qenë aty ku është tash, tash që e rregulloi ky Grujevski biliardat që i shpenzoi. Merreni me mend edhe perdja e skenës është prej kadifes t'njejtës çfare ka qenë. Unë nuk kam qenë, por po tregon vllaznit e mi kanë qenë, motrat e t'kumatës kanë shku, kanë pa pjesë teatrale edhe karrigat, të njejtat karrige janë ba, kadifja e njejtë, vetëm një kat e kanë çu ma naltë edhe hymjen e kanë bo kah ni anë tjetër, e jo andej kah ka qenë edhe, domethanë, punojnë me mend për popullin e vet për ashtu tek ne, tek ne jo që tanët kanë pasë faj, po ashtu ja u kanë dhanë atë lokacion.

Kaltrina Krasniqi: Pse nuk keni studiu?

Ajtene Pllana: Urdhno?

Kaltrina Krasniqi: Pse nuk keni studiu?

Ajtene Pllana: Pse s'kam studiu? Ku të studioj çika jeme u martova menjëherë i linda katër fëmijë, punoja s'kisha... ai burri im shumë ishte ambicioz, njëherë më regjistori hajde po thotë, "Gjuhët po t'shkojnë, po t'regjistroj në letersinë Jugosllave ka nevojë gjuhën shqipe me e dhanë në paralele shqipe" thashë, "Ti regjistrom unë nuk shkoj, nuk kam kohë unë mos me mësu me shku aty pa ditë nuk kam kohë, nuk kam kohë", po ai s'i ka qenë ambicioz m'regjistroi. I thashë, "Merre indeksin, mbaje ti se unë nuk shkoj n'fakultet", edhe nuk shkova.

Dikur më regjistroi në frengjisht, frengjishtja m'ka shku shumë në shkollë, në Normale. Mandej profesoresha thoshte, "Vetëm Ajtene Gashi...", edhe ni shok e kam pasë prej paraleles tjetër, "Vetëm Ajteni edhe ai munden me e studiu frangjishten kërkush tjetër", aty katër-pesë vetë, bile shoku im i klasës ka qenë shumë i zgjut doktoroi në Sorbonne e kreu frengjishten. Ajteni erdhi këtu katër fëmijë, punë, por mjaft iu përkushtova fëmijëve, vajzave duheshte punë me ta. Unë s'kam qenë ashtu e aftë që t'mundem edhe të studioj edhe familjen ta mbaj edhe fëmijët të kujdesem për fëmijtë.

Kaltrina Krasniqi: Kur jeni pensionu?

Ajtene Pllana: Kur jam pensionu, që moti, ka 22 vjet.

Kaltrina Krasniqi: Edhe qysh ka qenë ajo ndjenjë për juve? Se ju faktikisht ni pjesë shumë t'madhe t'jetës e keni kalu n'shköllë.

Ajtene Pllana: Po, në fillim shumë vështirë e kisha. Në orën 12:00, gjithmonë kam fillu mësimin në orën 12:00 edhe në 12:00 dilsha niherë prej ktuhit shkojsha deri në atë skej në anën tjetër t'shköllës edhe njëherë dojsha ta dëgjoja atë zhurmën e fëmijëve të arsimitarëve e sende. Edhe një ditë vajza m'tha, "Pse nana po del?" Ai burri jem tha, "E ka marr malli s'ka bërtitë moti", thashë, "Kush ka bërtitë?" Tha, "Ta kam ndi zanin prej atyhit", (qeshë) thashë, "A ke dëgju a?" Tha, "Po, por nuk t'kam kallxu", ashtu. Edhe kisha mall, a din, nuk e kisha lehtë. Mirëpo, jam rregullisht në kontakt me nxënësit e mi.

Merreni me mend para dy vitesh më dha ni medalje këtu për ditën e mësuesit në komunë edhe kur mbas asaj kur po shof nxënësit e mi të gjeneratës t'parë në "Emin Durak" që kam punuar u paraqitën, "Mësuese...", njana shumë aktive, Naza Sejdiu, ajo ka organizu një mbramje atë natë me kalu në një kafiteri dikund edhe nja dymbëdhjetë a 15 nxënës të asaj kohe që të gjithë ishin pensionuar tash. Unë nuk i njifsha asnjërin vetëm atë Nazën. Shkova atje, ata... bile ata erdhën pas meje unë shkova pak ma përpara edhe po thonë, "A kjo është mësuesja jonë?" Thashë "Po" (qeshë). Ata të gjithë mo burra janë ashtu edhe pyeta, "Kush ka qenë në klasën tonë?" I kam harruar emrat vetëm një vit shkollor punova. Merreni me mend mora vesh aty se Isa Mustafa paska qenë nxënësi im, ish kryetari, edhe tash thashë, "Isa Mustafa nxënësi im?" "Po" tha, thashë, "Çfarë nxënësi ka qenë?" Thanë, "Mësuese s'ka pasë nxënës ma t'mirë. Ndaq në shkollë fillore, ndaq në gjimnaz, ndaq në fakultet i hatashëm ka qenë." Thashë, "Mirë, po m'vjen mirë", i sheh gjeneratat krejt të pensionuar tash shumica.

Kaltrina Krasniqi: Edhe mandej kur ndrroi jetë burri juj?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Kur ka ndrru jetë burri?

Ajtene Pllana: Me 4 janar 1994, moti.

Kaltrina Krasniqi: Shumë moti.

Ajtene Pllana: Po, në gjum. Atë natë ndejtëm deri... ishte viti i ri më patën ardhë, domethanë, 3 janari ishte, me 4 janar a thashë me 4 janar? Ishte motra ime me bashkëshortin ndejtëm këtu një kohë, ishte djali edhe vajza vëllaut nga Shkupi. Ndejtëm një kohë t'gjatë u çu edhe i çoi deri në shtëpi motrën edhe dhëndrrin tim. Ata s'kishin automobil ashtu kah ora 12:00 e natës. Ne i lutëm të flenë këtu, "Kemi vend", motra ime "Jo, jo nuk mundem" thotë, "do t'shkojmë në shtëpi", edhe i çoi deri atje.

Erdhi, ndejtëm këtu një kohë edhe mbani pak masazh thash, "Bonëm pak masazh...", ata qeshnin fëmijët thanë, "Enishte po t'lodh ma shumë" thotë, "hajde shko bjer", "Qe..", tha, "A po e sheh tash edhe masazh po thotë t'i boj" qeshëm kështu. U bo ora gati 01:00 edhe u çumë me fjetë, ai tha, "Me djalin e vëllaut po shkoj naltë n'dhomën e fjetjes atje me fjetë edhe n'mënges grua t'ma bijsh ni çaj në krevet". "Ani" i thashë, ai djali i vllaut dreq po thotë, "A ni çaj a dy çaja?", "Jo, jo" tha, "Veç një", axha Gynsel, për vllaun, dy i pin në krevet", "Jo..." tha, "Unë kurrë nuk pi po nesër p'e du një çaj", e vajza mbet këtu.

Kjo dhoma është bashkë me atë tjetrën sallon e kemi po mandej e kemi mbulu ajo atje fjet. Unë këtu... Në mëngjes u çum edhe i thash vajzës i thashë, “Shko shif nalt a u çu enishtja t’i çoj një çaj”, kur erdh e zbehtë tha, “Halla,” tha, “eja me pa, mu po m’doket enishtja po flen”, dhe menjëherë e dita çka ka mujt me ndodhë. Kur shkova e kishte lëshu Radio Tiranën ora ishte 8:10, një muzikë e lehtë ashtu atë... për, merrte diçka për tension do hapa kështu, as s’e ka prek bile aty në komodë trupin ende t’nxehët kishte ndrru jetë, 63 veçar.

Kaltrina Krasniqi: Shumë i ri.

Ajtene Pllana: I ri, i ri, qe kështu. Fëmijët i kisha jashtë. E pata shumë t’vështirë, shumë t’vështirë e pata, që të katër fëmijë jashtë. Pastaj m’u desht djalit, shkonte në një gjimnaz shumë të mirë mësonte atje edhe vajzat ishin aty Vjollca dhe Arta, por mos me m’lanë mu vetëm u kthy edhe ai, qe kështu mandej këtu.

Kaltrina Krasniqi: Tregomni tash pak për librin. Ka ardhë koha me ma spjegu krejt rrugëtimin që e keni bo për librin e juj që e keni botu sivjet?

Ajtene Pllana: Nganjëherë po m’duket shumë qesharake që e botova, por unë s’e di a ju tregova. Fillova të shkruaj tregime kshtu ngjarje prej jetës s’kisha çka t’bëj, n’mëngjes po zgjohem shumë herët. Unë jam shumë herake, në orën 4:00, në orën 3:00 jam zgjut edhe shkrujsha. Kur po m’thërret vajza prej Londrës, “Çka po bon nana?” Thashë, “Po shkruaj”, “Çka po shkruan?” Thashë, “Qe po shkruaj diçka prej fëminisë, diçka po du t’ua la si kujtim juve”. “E çka janë ato?” Thashë, “Diçka si tregime”.

Bile i tregova Rronit, djalit t’vajzës në Amerikë, që po shkruaj sa shpejt ma ka dërgu një fletore aq t’bukur, bile e kam aty, edhe mbrenda e ka ni kartolinë ashtu të ngjitun në ato, në fletore edhe po shkrun. Ai ka lindë e është rrit atje shqipen po e flet po natyrisht pak edhe po thotë, “Gjyshe është një plan perfekt” thotë, “kjo që po shkruan” thotë edhe diçka tjetër ashtu. Eh thashë, “Rronit po du me ia plotësu dëshirën se ish gëzu djali”. Ai ishte atëherë absolut i akademisë t’muzikës atje thash do t’shkruaj.

Kur i dëgjoi Vjollca tri tregimet e para, “Nana shumë bukur”. Ishte ajo këpuca e mbetur në rrugë prej dy vjet e gjysë... tash unë krejt atë ditë nuk e mbaj, por atë kryesoren e mbaj, për mu ishte me rëndësi këpuca që mbeti në rrugë, e nana tha, “Lene”. Por fëmijë, në vend se ta marrë në dorë po e lash aty si tha nana, “Lene këpucën, vrapo” kalonin aeroplanat, ‘41-shi prill. Edhe thashë, mu kështu fillova të shkruaj. Tash Vjollca çdo mëngjes prej Londre, “Nana a po shkruan?”, “Po, po”, “Hajde lexoma”, edhe unë ja lexoja secilën, “Nana shumë mirë, shumë interesant, shumë interesant”.

Thashë, “Vjollca, nana...” “Hajde, nana shkruaj të lutem”, edhe ato rriteshin çdo ditë nga një, nga dy, nga s’disha nga t’ia mbaj se krejt i mbaj ndoshta edhe pesëqind tregime i di ngjarje qishtu t’jetës edhe parvjet kur shkova ajo filloi me e shtyp tha, “Nana a e din çka? Do t’bajmë, do ta bajmë një libër”, them, “A je n’veti ti”, gjashtëdhjetë i pata shkrujt “Hajt ti...” po thotë, mandej them, “S’janë këto nana”. “Shumë...” po thotë “Edhe stili edhe krejt nuk është, ti s’ke pretendime letrare por është interesant”, une qeshesha bojshim hajgare rreth asaj që do ta shypim edhe...

Kaltrina Krasniqi: Mandej?

Ajtene Pllana: Edhe pastaj parvjet kur erdhi këtu, jo vitin e kaluar, veç fillova... Erdhi një ditë si e ka emrin kjo, Flaka Surroi, poshtë të pijë kafe te vajza ime edhe Arta i kishte tregu, vajza, i ka thanë “A din cka, nana po i shkruan disa tregime”, “Hajt t’i shof”. Ia tregova, e lexoi atë të parën tha, “Shumë mirë mësuese” se ka qenë nxënëse në shkollën tonë, tha, “Vazhdoni”. Kjo vajza ime mori edhe pak guxim, a din, edhe vullnet ashtu, “Kryj nana çka ke tjetër, çka të doket më interesant shkruj” Derisa u bonën 72, “A din çka?” Tha, “80 tregime, 80 vjet kam me ta festue edhe me e bo për ditëlindje tane t’botohet”. “Vjollca, a je n’veti?” Mu më kapi panika, “Nana janë shumë interesante”, edhe kështu u ba mandej ja dërgoi Flakës atë shtypjen e parë që e boni në asi tha, “Shikoje”, tha ashtu, “Libër i veçantë”, ashtu shumë, shumë i pelqeu. Mandej, vetëm duhet natyrisht diçka të rregullohet, unë nuk jam as letrare, as gjuhëtare që... edhe mandej herën e dytë kur ia çoi thotë, prapë e çmoi kështu i dha pëlqimin edhe tha, “Mund të botohet”, e botojmë edhe që kështu u botu libri. Unë mbeta e habitur (qeshë) krejt është puna e vajzës sime ajo është shumë e vendosur, shumë e vendosur edhe thotë, “Për ditëlindjen e tetëdhjetë këtë libër e ke” dhe mendoj ne e botum me shpenzimet tona jo me t’ashtu edhe që kështu doli.

Kaltrina Krasniqi: Plot njerëz e kanë lexu librit cilat janë komentet?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Plot njerëz e kanë lexu librin...

Ajtene Pllana: Po, kumeditë mu, mua s’po... diku po i pëlqejnë shumë ato të fëmijërisë. Po m’i përmendin disa të shkollës, disa rreth jetës tonë, rreth burgosjes t’babës ato. Mandej, ajo çka është shumë interesante është eksodi i shqiptarve në Turqi edhe sidomos vajzës time i boni shumë përshtypje ekskurzioni se di a e keni lexuar?

Kaltrina Krasniqi: Po.

Ajtene Pllana: Ajo krejt me qëllim si duket është organizuar, se ishte në kohë ku u ndërpre pak sigurisht se nuk kishim qasje, nuk kishim mundësi me shku në Turqi, nuk kishte të dretjë, të shkojsh edhe të mos kthehesh, por si turist jo, edhe nuk e dinim se çka është, çka të ofron, çka të sjell Turqia. Edhe autobusi që shkoi atëherë kur u kthyen edhe i kanë shëtit nëpër vendet ma t’bukura. Ka Turqia vende t’bukura, por nuk e kanë çu atë mjerimin me pa, atë papunësinë atë ashtu... Para 60 vjetëve ka qenë shumë ndryshe Turqia nuk është si sot.

Edhe mandej ajo e aty vllau im kur baba një ditë ndoshta e keni lexu, një ditë babës i erdhi deri ktu {tregon me duar} baba doli prej burgut po e dinte që janë gjithmonë në mbikqyrje tha, “A din çka”, edhe shkon në ambasadë s’ka pasë, por çka është ajo, në konsulatën turke edhe kërkon... edhe ia çon atë që ia kishe çu një shok një garancë mirëpo ka thanë, “Çka je ti, shqiptar apo turk?” “Jo,” thotë, “Shqiptar” thotë, “bile shqiptar i madh”, “Shqiptar, rri këtu” thotë, “Nuk mundesh me shku në Turqi” edhe kur mori vesh vllau i madh Amiri që posa kish dalë prej po ende s’pat’ hy në burg atëherë edhe u pat’ nervozu shumë thotë, “Kënd e pyte ti kënd, ne s’do t’shkojmë do t’ju rrijmë para hunve s’po shkojmë”, dhe prej lagjes tonë vetëm ne mbetëm në lagjen tonë vinin maqedonët i blenin shtëpiat e kështu, nuk shkuam.

Kaltrina Krasniqi: Pse shkonin në Turqi?

Ajtene Pllana: Si?

Kaltrina Krasniqi: Pse shkonin...

Ajtene Pllana: Pse shkonin në Turqi? Po u ofroheshite ni jetë ma e mirë ma ashtu... edhe shifeni, tash po shof njerëzit tanë po shkruajnë nëpër gazeta e sene. Shqipëria nuk po u hap shkolla shqiptarëve atje nuk është sepse çdo ditë, s'kalonte muaji po vjen ndonjë udhëheqës i Turqisë, një herë në Shkup e në Beograd ka qenë sidomos ni Fuad Këprylyn ajo ka qenë ndonjë Ministër i Punve të Jashtme ose diçka ai vinte shumë shpesh. Edhe nuk mundeshe të kërkosh të bartesh në Turqi pa të dërguar dikush nji garancë edhe vet do t'declarohesh në ambasadë, në, këtu në konsulatë se je turk, jo se je shqiptar.

Ajo krejt është bo me qëllim, se nëse thojnë që janë shqiptar nji ditë do t'kërkojnë të drejta, apo, edhe shkolla edhe sene. Prandaj njerëzit kot e kanë sot kur kërkojnë shkolla në gjuhën shqipe. Pse s'ka shkolla në gjuhën shqipe? S'ka se ti je paraqit si turk dhe nuk t'jep. Qato ishin gjanat që kush mendonte pak ma tepër nuk shkonte. Megjithëse, njerëzit tanë u gjinden shumica mendoj në kohët e fundit ato gjeneratat e para, jo nuk mundeshin të shkollohen. Rrallë kush, dikush duhet të punonte. Ishte lufta për ekzistencë, mirëpo tash kanë arritë shumë.

Unë shof kunata ime shkoi me tetë fëmijë, shkuan ata nipat e mbesat janë ba mosvet edhe po shkollohen edhe krejt mirëpo e kanë humbur identitetin. Vetëm gjenerata e vjetra që kanë mbetë si unë edhe vajza e kunatës e djali i kunatës ndërmjetveti flasin shqip tjerët krejt turqisht. E prandaj ishte, dikush kush mendonte ma tepër e duronte edhe atë jetë pak ma t'randë në atë kohë, a din, mos me lanë vendin mos me shku. Po ashtu edhe vetëdija nuk ishte shumë e ngritun, a din, kryesisht njerëz t'pa shkollum, pa ashtu jo që me ditë pak me llogaritë pak për të ardhmën, a po, qe kështu.

Kaltrina Krasniqi: Çka keni mësu për 80 vjet jetë?

Ajtene Pllana: Çka?

Kaltrina Krasniqi: Çka keni mësu për 80 vjet jetë?

Ajtene Pllana: Ooh, çka kam mësuar, çka kam mësuar. Shumë gjana (qeshë) kam mësuar edhe pse 80 vjet, 80 (qeshë) vjet jetë. Të dish të luftosh për jetën. Në qoftë se mundesh, por unë s'jam ashtu luftarake, nuk jam ashtu, edhe ndonjëherë them të kisha kry diçka më tepër edhe të kisha asi, po papë edhe kështu mirë është a po. Çka tjetër nuk, kurgjo konkret ma tepër se atë që kam mujt me arritë jo. Mendoj, jam e kënaqur me profesionin që kam zgjedh, mendoj është njëra nga profesionet ma t'shejta, ma t'vlefshme edhe pse dikush, dikush nuk e çmon ndoshta. Por të jesh mësues, të punosh të nxjerrësh treqind e sa fëmijë në dritë është diçka e madhe, diçka e vlefshme edhe qishtu.

Mandej fëmitë e mi kanë arritë, nji jetë normale bojmë kurgjo ma tepër. Nuk kemi asi synime megallomane të pasunohemi. Normal, nji jetë normale ashtu si mundet çdo intelektual ashtu me e kalue, qe kështu. Kam shëtitë mjaft botën, aty, aty kam pa, kam... mundet edhe ma mirë, kanë mujt gjanat të ndodhin edhe gjana ma t'mira po nuk jam shumë e preokupume ashtu, jam e kënaqur.

Kaltrina Krasniqi: Prej familjes t'juj t'afërt prej motrave edhe vllaznive kush ka mbetë?

Ajtene Pllana: Unë kam, kam një vlla, një motër vetëm edhe dy vllazën që të dy tani janë pensionistë, aty bile në libër e kam fotografinë. Ai ma i vogli edhe është pensionit. Ka qenë gaze... albanolog,

gazetar ka punuar në Radiotelevizionin e Prishtinës edhe bashkëshortja e vet edhe ajo ishte albanologe, gazetare, por kur u mbyll televizioni u desht të kthehen në Shkup. Fëmijët i lindën këtu, dy fëmijë, atje edhe ni vajzë. Kështu që tash vllau asht' pensionuar qe një vit, ata hapat e parë i bonën këtu në Prishtinë edhe kanë një familje shumë të mirë.

Vllau tjetër që e kam gjallë edhe ai është jursit edhe ai është pensionuar. Përkthen prej turqishtes shumë libra kështu të vlefshëm në maqedonisht e prej maqedonishtes në turqisht. E vëllau i madh, ate që e kemi pasë shtyllë t'familjes, ai ndrroi jetë në moshën 64 vjeçare, 74 vjeçare. Ishte jurist, ai ka qenë i burgosur politik, ai tjetri biçiklisti edhe ai ndrroi jetë para katër-pesë vitesh. Kështu kur shkojë kam mall për ata vlezër... se ne, baba im nuk kishe as vëlla as motër, nana e Preshevës në Shkup kështu që ne nuk kishim farefis atje.

Baba ka pasë ni axhë të moshuar me një vjazë atje edhe ai vdiq në '54-shin axha nuk la, e la vetëm atë vajzën. Edhe ajo më vonë u martua, e kreu frengjishten e studioi. Ishim shumë të vetmuar në Shkup, të thuash, si ni dru në shkretinë kur ta lësh. Mirëpo, u rrit familja gjashtë fëmijë prej të gjithëve fëmijë, fëmijë tash fëmijët e fëmijëve edhe kështu tash kur shkoi takohem ata vijnë ktu kalon një jetë.

Kaltrina Krasniqi: Edhe një herë që me qenë t'saktë. Ju keni lindë në vitin 1938 apo?

Ajtene Pllana: '38'shin, po.

Kaltrina Krasniqi: Okej, shumë faleminderit ke shumë kënaqësi me fol me juve.

Ajtene Pllana: Faleminderit edhe prej jush që gjetët kohë edhe interesi se di.

Kaltrina Krasniqi: Shumë u knaqëm, shumë u knaqëm, faleminderit shumë.

Ajtene Pllana: Ashtu? Faleminderit, faleminderit.